



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 11.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 10.04.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rehabilitimi i rrugëve më asfalt Qerim,Piskot,Brekoc,Blloku i ri,Has,Reka e keqe,Rekë e mirë.Dushkaj”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-812-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-008-511, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik “JOOS & KRASNIQI - BAZE” sh.p.k., e dt.10.04.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rehabilitimi i rrugëve më asfalt Qerim,Piskot,Brekoc,Blloku i ri,Has,Reka e keqe,Rekë e mirë.Dushkaj”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-812-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-008-511 kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 21.02.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të publikuar me datë: **21.02.2025;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori ekonomik “JOOS & KRASNIQI - BAZE” sh.p.k. me dt.10.04.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rehabilitimi i rrugëve më asfalt Qerim,Piskot,Brekoc,Blloku i ri,Has,Reka e keqe,Rekë e mirë.Dushkaj”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-812-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-008-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 11.04.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet tuaja lidhur me kriteret që kanë të bëjnë me makineritë dhe stafin teknik, janë të pa bazuara. Autoriteti kontraktues konsideron se kërkesat në FDT, janë të domosdoshme, duke pasur parasysh që kemi të bëjmë me rehabilitimin e rrugëve dhe kanalizimeve. Këto kriteret janë përcaktuar jo të kufizojnë konkurrencën dhe nuk përbëjnë pengesë për pjesëmarrje të drejtë në procedurë, por kanë për qëllim të sigurohet që operatorët ekonomik pjesëmarrës të kenë kapacitet për të përmbushur me sukses detyrimet që rrjedhin nga kontrata.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Kësbilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankese pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj

për: Xhufman

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

